



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6.3.2024

Nr: 28

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E FLETËS TIP PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR NISMËN
LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR
PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6, nenit 10 dhe nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”,

VËREJ:

Organizata “Shqipëria Bëhet”, me komitet përfaqësues të përbërë nga: Adratik Lapaj, Edlira Cepani, Florian Binaj, Renaldo Salianji, Ergys Llanaj kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 485 Prot., datë 20.02.2024, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Bashkëlidhur kërkesës, komiteti përfaqësues ka depozituar:

- Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
- Relacionin shpjegues të projektligjit.

Projektligji që do t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, ka për qëllim të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme për të mundësuar votimin e të gjithë shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga vendi ku ata banojnë dhe të rregullojë instrumentet se si do të realizohet procesi i regjistrimit dhe votimit të tyre. Gjithashtu, ky projektligj adreson mënyrën e hapjes së listave dhe votës së parapëlqyer për secilin kandidat të subjekteve zgjedhore, përcaktimin e formulës së llogaritjes së mandateve dhe pragut elektoral për subjektet zgjedhore.

Në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë me vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të KQZ-së, në një format të shkarkueshëm. Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në një rën anë duhet të përmbajë informacion mbi nismën ligjvënëse që do t’i propozohet

Data: 6.3.2024 Nr: 28
Ora: 12:00



“Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë/komitetin përfaqësues të nismës. Në anën tjetër duhet të përmbajë: numrin rendor, gjenealogjinë e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin dhe datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Referuar nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës për pajisjen me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve, përcakton me vendim, sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike.

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban informacion mbi nismën ligjvënëse që do t'i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës. Nga kërkesa e depozituar pranë KQZ-së, nuk është përcaktuar një periudhë kohore për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve.

Me kërkesën nr. 591 Prot., datë 29.2.2024, të depozituar pranë KQZ-së për plotësim dokumentacioni, periudha e propozuar nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve është 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6, nenit 10 dhe nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S:

1. Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe publikimin e saj në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të realizohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

FLETË TIP PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Nr.	Emri, Atësia, Mbiemri	Datëlindja (data, muaji, viti)	Vendlindja	Nr. i kartës së identitetit ose pasaportës	Nr. Tel	Nënshkrimi i zgjedhësit
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						

Grupi i mbledhjes së nënshkrimeve

(emër, mbiemër, firma)

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Organizata “Shqipëria Bëhet”, me Komitet Përfaqësues të nismës ligjvënëse të përbërë nga:

- Adriatik Lapaj
- Edlira Cepani
- Florian Binaj
- Renaldo Salianji
- Ergys Llanaj

kërkon t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili ka për qëllim të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme për të mundësuar votimin e të gjithë shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga vendi ku ata banojnë dhe të rregullojë instrumentat se si do të realizohet procesi i regjistrimit dhe votimit të tyre.

Gjithashtu, ky projektligj adreson mënyrën e hapjes së listave dhe votës së parapëlqyer për secilin kandidat të subjekteve zgjedhore, përcaktimin e formulës së llogaritjes së mandateve dhe pragut elektorale për subjektet zgjedhore.